P.nr.384/16

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Divizioni penal, me gjyqtarin Lulzim Paçarizi, si dhe sekretarja juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Q. Z., për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.2 dhe 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe lidhur me nenin 2 nënparag.1.1.2 dhe nenit 1.2 nënprarag 1.2.4 të ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, ndërsa sipas aktakuzës PP.nr.1309/2016 të dt.14.12.2016, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar publik të dt.19.10.2017, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu, të akuzuarit Q. Z., e gjykata me dt. 20.10.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: Q. Z., nga i ati A. dhe e ëma H. e lindur Sh., i lindur më .... në fshatin Ll., komuna e Malishevës, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se ditën kritike me dt. 14.09.2016 rreth orës 16:00 h, në shtëpinë e tyre të përbashkët e cila ndodhet në fsh. Ll. komuna e Malishevës, përdor forcën ndaj personit tjetër, bashkëshortes M. Z. (viktimë e ndjeshme) në atë mënyrë që jasi ia lexon mesazhet e dashurisë dhe e kupton se bashkëshortja e tij po e tradhton , fillimisht fillon dhe konfrontohet verbalisht me të, dhe për një moment përdor forcën ndaj saj duke e goditur me grusht dhe me një shufër trupit nga (materiali i plastikës) dhe me pas e dëbon nga shtëpia.

-me çka ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 187 par.2 dhe 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe lidhur me nenin 2 nënparag.1.1.2 dhe nenit 1.2 nënprarag 1.2.4 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Andaj gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 par.1 pika 1.1, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit i`a shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë)** muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara M. Z., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohen në kontestin e rregullt civil.

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t`ia paguajnë shumën prej 20 euro ndërsa shpenzime të procedurës penale shumen prej 20.44 euro.

Të tëra këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore-Gjakovë me aktakuzën PP.nr.1309/16 të d.t 14.12.2016, e ka akuzuar Q. Z., për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.2 dhe 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe lidhur me nenin 2 nënparag.1.1.2 dhe nenit 1.2 nënprarag 1.2.4 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të gjitha provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt.19.10.2017 ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, i akuzuari Q. Z., andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

Pas deklarimit të akuzuarit Q. Z., për pranimin e fajësisë, gjykata kërkoj qe mendimin e vet ta jep prokurori i shtetit.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu jep mendimin se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoj fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, po ashtu e dëmtuara ka dhen deklaratë në prokurori me dt. 28.09.2016, ku nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe e ka ndier veten fajtore, andaj i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari Q. Z. deklarohet i fajshëm , për të gjitha pikat e akuzës, duke shuar se më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, me të dëmtuarën M. jetojmë së bashku, ku i kemi dy fëmijë, ku nga ai rast nuk kemi kurrfarë problemi në mes vete, e di që kam gabuar për të cilin jam penduar thellë, andaj kërkoj na gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, meqenëse tani jeta jonë bashkëshortore me M. është normale, pa kurrfarë problemi.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 326 të KPPK-së, ka deklaruar se është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe ka shtuar se ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi që është kryerës i kësaj vepre penale që akuzohet sipas aktakuzës, andaj ne tersi ka pranuar fajësinë, dhe se pranimi i fajësisë është i mbështetur në provat të cilat i janë ofruar gjykatës si: raporti mjekësor i Q.K.M.F – Malishevë, me nr. të protokollit 12618 i dt.14.09.2016, për të dëmtuarin, ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.V. K. me nr. të referencës 27/2016 të dt.14.11.2016, dhe shkresat tjera, janë prova të mjaftueshme dhe te besueshme për të shpallur fajtor të akuzuarin.

Pas vlerësimit të te gjitha provave si dhe pas deklarimit të përfaqësuesit të akuzës si dhe vet të akuzuarit gjykata gjeti se ne veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.2 dhe 3 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe lidhur me nenin 2 nënparag.1.1.2 dhe nenit 1.2 nënprarag 1.2.4 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Gjatë matjes së dënimit gjykata kishte parasysh rrethanat lehtësuese dhe atë faktin se i akuzuari kishte sjellje të sinqerta gjatë shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, i ati i 2 fëmijëve, i pa punë dhe i gjendjes së dobët ekonomike, ndërsa nuk ka gjetur rrethana rënduese, mu për këtë i shqiptoj dënimin me kusht ne kohëzgjatje prej 6 muajve, një vit verifikimi, me bindje se edhe me një dënim të këtillë do të arrihet efekti pozitiv i qëllimit të dënimit, në pajtim me nenin 73 të KPK-së, ashtu që i akuzuari në të ardhmen të mos kryen vepra të ngjashme penale si dhe çfarë do lloj tjetër të veprave penale.

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin e rregullt civil gjykata e mbështeti në nenin 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 nënparag.2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMEMLORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
P.nr.384/16, me dt.20.10.2017

Sektretarja juridike
Behije Karaçica

G j y q t a r i
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.